



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA GJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të nenit 12 të Rregullores MF – NR – 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për Mbështetje Financiare Publike të Organizatave Jo-Qeveritare në Zbatimin e Aktiviteteve të Sportit

1. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Gjakovës, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit, të aplikojnë me projektet/programet e tyre në fushat prioritare si në vijim:

- a) *Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës të cilat janë të Licencuara dhe programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Sportit.*

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte të cilat do të kontribuojnë në zbatimin e programit të DKRS, si më poshtë:

- a) Aktivitetet që kanë për qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës së Sportit tek shoqëria civile e më gjerë;
- b) Bashkëpunimi i institucioneve publike dhe akterëve tjerë me shoqërinë civile për nxitjen dhe promovimin e aktiviteteve në fushën e Sportit;
- c) Organizimi i aktiviteteve për shënimin e ngjarjeve të ndryshme me rëndësi;
- d) Mbështetja e aktiviteteve të përgjithshme Sportive;
- e) Avancimi dhe promovimi i vlerave të mirëfillta në fushën e Sportit.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 170,000.00 euro. Për OJQ-të të cilat aplikojnë me projekte për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve, shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një (1) projekt është 500 euro, ndërsa shuma maksimale për një (1) projekt është 40,000.00 euro.

4. Aplikantët dhe partnerët potencialë, për pjesën tjetër të kostove mund të sigurojnë bashkëfinansim nga donatorët dhe burimet tjera publike apo burimet vetanake.

5. Afati për dorëzimin e propozimeve fillon nga data **24.04.2026** dhe përfundon me datën: **18.05.2026**

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti dy (2) projekte në kuadër të kësaj thirrje, por vetëm një (1) projekt mbështetet për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

7. Periudha e zbatimit të projektit është brenda vitit.

8. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Sportit dhe aktiviteteteve të përfshira në kuadër të kësaj thirrje publike.

9. OJQ-të duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare.

10. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një (1) vit para datës së publikimit të thirrjes publike.

11. Aplikuesit së bashku me aplikacionin duhet të prezantojnë:

- Certifikatën e numrit fiskal;
- Certifikatën e regjistrimit;
- Letër konfirmimin e personit të autorizuar të OJQ-së;
- Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar;
- Vërtetimin nga Komuna e Gjakovës me të cilin vërtetohet që OJQ-ja nuk ka obligime financiare ndaj Komunës së Gjakovës;
- Vërtetimit Tatimor të ATK-së;
- Vërtetimin e Gjykatës Ekonomike të OJQ-së.

12. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimin për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Gjakovës (kk.rks-gov.net/gjakove/).

13. Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht ose me postë në adresën: Rr.“UÇK” p.n. 50 000 Gjakovë, Republika e Kosovës / zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi”.

14. Procesi i sqarimit, pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve si dhe të vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues të zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimin për aplikim të thirrjes publike*.

15. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë dhe i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike.

16. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS-së në adresën: Rr.“UÇK” p.n. / zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” dhe në email adresën: drenusha.nixha.hoxha@rks-gov.net deri më datën: 06.05.2026